



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.11/1**

**12 shkurt**

**2009**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MB nr.46, datë 23.1.2009	Për procedurat e pastrimit të dublimeve nga baza e të dhënave e regjistrit kombëtar të gjendjes civile dhe regjistrit themeltar të shtetasve .....	3
Udhëzim i MB nr.53, datë 29.01. 2009	Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së formatit të njoftimit dhe masat për pajisjen me përparësi me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë që nuk disponojnë pasaportë.....	6

**UDHËZIM**  
**Nr.46, datë 23.1.2009**

**PËR PROCEDURAT E PASTRIMIT TË DUBLIMEVE NGA BAZA ETË DHËNAVE E  
REGJISTRIT KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE DHE REGJISTRIT THEMELTAR  
TË SHTETASVE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1 të nenit 11, të nenit 12 të ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 20.3.2003 “Për rregullat dhe veprimet e zyrave të gjendjes civile dhe për detyrimin e shtetasve për transferimin e të dhënave të gjendjes civile”, me qëllim krijimin e një baze të dhënash të sakta dhe me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

**UDHËZOJ:**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, duke u bazuar në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, identifikon dhe harton në format elektronik dhe të printuar në letër listën e shtetasve të dubluar, për çdo zyrë të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë, të grupuar si:

- a) Dublime brenda së njëjtës zyrë të gjendjes civile.
- b) Dublime ndërmjet zyrave të gjendjes civile.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, brenda datës 26.01.2009, ndan listën e shtetasve të dubluar për çdo zyrë të gjendjes civile, si dhe programin kompjuterik të dublimeve në CD.

3. Zyra e gjendjes civile, pasi merr materialet e dorëzuara nga DPGJC-ja, fillimisht instalon programin kompjuterik nga CD-ja në kompjuter. Procedura e instalimit jepet e detajuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, fillon punë me listën e printuar të shtetasve të dubluar jashtë njësisë. Për këtë qëllim do të përdoret programi kompjuterik i dhënë nga DPGJC-ja i cituar në pikën 3. Për çdo rekord në listën e dublimeve, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kontrollon në Regjistrin Themeltar datën e regjistrimit në këtë zyrë. Këtë informacion e hedh në programin kompjuterik të dublimeve, dhe më konkretisht: plotëson në kolonën përkatëse datën e regjistrimit sipas rastit: transkriptuar nga regjistri 1974 ( për këtë kategori do të vendosim datën 1.01.1974), regjistruar me aktlindje, ardhur me transferim nga zyrë tjetër, ardhur me martesë etj., si dhe numrin e regjistrimit dhe fletën ku ai figuron i regjistruar (d.m.th. plotëson të dhënat e rubrikës: shtesa).

Procedura që do të ndiqet për hedhjen e këtij informacioni në programin kompjuterik të dublimeve jepet e detajuar te pika 1 e aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky proces do të mbarojë brenda datës 29.01.2009.

5. Me plotësimin e pikës 4, programi kompjuterik i dublimeve duhet të kopjohet nga kompjuteri i ZGJC-së në CD ose media të tjera të lëvizshme. Procedura e kopjimit jepet e detajuar në pikën 3 të aneksi i bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Brenda datës 29.01.2009, përgjegjësit e ZGJC-ve, do të dorëzojnë pranë përgjegjësve të degëve të zyrave të gjendjes civile pranë qarkut/rrethit respektiv, CD-në (ose mediat të tjera të lëvizshme) me programin kompjuterik të kopjuar sipas pikës 5, listën e printuar nga programi kompjuterik të firmosur nga punonjësi. Këto materiale të jenë të shoqëruara nga një shkresë zyrtare.

7. Brenda datës 30.1.2009, përgjegjësit e degëve të zyrave të gjendjes civile pranë qarqeve duhet të dorëzojnë pranë DPGJC-së të gjitha materialet e dorëzuara sipas pikës 6.

8. DPGJC-ja përpunon gjithë informacionin e ardhur sipas pikës 7 dhe harton listat e përditësuara me informacion shtesë të dublimeve jashtë njësisë. DPGJC-ja brenda datës 01.02.2009 shpërndan listat e përditësuara me informacion shtesë të shtetasve të dubluar për çdo zyrë të gjendjes civile.

9. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, për listën e printuar të shtetasve të dubluar brenda njësisë, gjen, kontrollon dhe krahason përbërësit e gjendjes civile të këtyre shtetasve në Regjistrin Themeltar. Në rast se këto të dhëna, përputhen, atëherë çregjistrohen shtetasin në fletën ku ka regjistrimin më të hershëm dhe ruan përbërësit e gjendjes civile të tij në fletën ku ka regjistrimin e fundit.

Pasi ka mbaruar me veprimet në Regjistrin Themeltar, fillon procedurën e pastrimit në sistemin online të Regjistrit Kombëtar. Bashkon të dy rekordet, duke mbajtur si rekord aktiv të dhënat ku shtetasi ka regjistrimin e fundit. Procedura që do të ndiqet për bashkimin e dy rekordeve në sistemin online është bashkëlidhur këtij udhëzimi si aneksi 4.

Ky proces do të mbarojë brenda datës 29.1.2009.

10. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, pasi merr listën e përditësuar të shtetasve të dubluar jashtë njësisë sipas pikës 8, fillon punën për pastrimin e këtyre dublimeve. Për çdo rekord kontrollon në datën e shtesës.

Në rast se rekordi që ndodhet në këtë ZGJC figuron i regjistruar në një datë më të hershme se rekordi tjetër, atëherë punonjësi vepron vetëm mbi Regjistrin Themeltar, duke e çregjistruar këtë person. Të dhënat e nevojshme për çregjistrimin e tij si: në cilën ZGJC ka shkuar ky shtetas dhe të dhënat e tjera, si emri, numri dhe faja e Regjistrit Themeltar punonjësi i gjen tek rekordi tjetër i këtij dublimit.

Në rast se rekordi që ndodhet në këtë ZGJC figuron i regjistruar në një datë më të vonshme se rekordi tjetër, atëherë punonjësi vepron vetëm mbi Regjistrin Kombëtar të Shtetasve, duke çregjistruar vendbanimin e rekordit jashtë ZGJC-së dhe duke e bashkuar këtë të fundit me rekordin brenda ZGJC-së që mbetet aktiv.

Procedura që do të ndiqet për bashkimin e dy rekordeve në sistemin online është bashkëlidhur këtij udhëzimi si aneksi nr.4.

Ky proces do të përfundojë brenda datës 5.02.2009.

11. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile kontrollon korrektesinë e veprimeve dhe, nëse vëren shkelje, vendos për hapat e mëtejshëm për korrigjimin e veprimeve.

12. Nëse rast se shtetasit që figuronin të dubluar paraqiten në zyrën e gjendjes civile, nga ku ata janë hequr dhe nëse ata pretendojnë se janë me banim në këtë njësi, ata plotësojnë një kërkesë pranë zyrës së gjendjes civile përkatëse. Modeli i kërkesës është bashkëlidhur këtij udhëzimi si mod.K1. Zyra e gjendjes civile kryen procesin e regjistrimit rishtas pranë kësaj zyre të gjendjes civile. Këto ndryshime pasqyrohen në sistemin online të Regjistrit Kombëtar duke e çregjistruar nga zyra e gjendjes civile ku më parë ishte aktiv.

13. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komunë.

**MINISTRI I BRENSHËM**  
**Bujar Nishani**

**Mod K1**

KËRKESË \_\_\_\_\_, më \_\_\_ / \_\_\_ / 2009

**Drejtuar : Zyrës së Gjendjes Civile të:**

Bashkisë \_\_\_\_\_

Komunës \_\_\_\_\_

Njësisë Bashkiake \_\_\_\_\_

Unë \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_, rrethi \_\_\_\_\_, më  
\_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_, i biri i \_\_\_\_\_ dhe i \_\_\_\_\_, deklaroj në prani të punonjësit të  
gjendjes civile të ( B/K) \_\_\_\_\_ Z/Zj \_\_\_\_\_ se jam banor me vendbanim  
pranë kësaj njësie vendore që nga viti \_\_\_\_\_.

Meqenësë Regjistri Elektronik i Shtetasve më paraqet si shtetas të dubluar në \_\_\_\_\_ zyra të gjendjes  
civile, edhe në ZGJC të njësisë (B/K) \_\_\_\_\_ dhe në ZGJC të (B/K) \_\_\_\_\_  
paraqes kërkesën time si vijon:

Duke qënë se unë dhe familja ime që prej \_\_\_\_\_ vjetësh banojmë dhe ushtrojmë të gjitha të drejtat  
tona pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore( B/K) \_\_\_\_\_, kërkojmë të regjistrohemi si  
banorë të zgjc të kësaj njësie vendore dhe të hiqemi nga Regjistri Themeltarë i ZGJC të njësisë  
vendore (B/K) \_\_\_\_\_.

Për sa deklarojam më sipër mbajmë përgjegjësi të plotë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në  
fuqi.

**DEKLARUESI**

**PËRGJEGJËSI I ZGJC(B/K)** \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
( Emër, atësia mbiemri)

\_\_\_\_\_  
( Emër, atësia, mbiemri)

\_\_\_\_\_  
( nënshkrimi )

\_\_\_\_\_  
( nënshkrimi )

**UDHËZIM**  
**Nr.53, datë 29.01. 2009**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PERMBAJTJES SE FORMATIT TË NJOFTIMIT  
DHE MASAT PER PAISJEN ME PERPARESI ME LETERNJOFTIM TE SHTETASVE  
SHQIPTARË QË NUK DISPONOJNË PASAPORTË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit të Këshilit të Ministrave nr.50, datë 23.1.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në të vendimit të Këshilit të Ministrave nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, pikat 4, 5, 10, 10/1.

**UDHËZOJ:**

1. Kryetari i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës, pasi merr nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nepermjet prefekteve, listën emërore të shtetasve që nuk disponojnë pasaportë, ia dërgon menjehere zyrës së gjendjes civile, për të plotësuar njoftimet për cdo shtetas dhe për ta ndare listen në përputhje me këtë udhëzim.

2. Jo me vonë se data 3 shkurt 2009, kryetari ben ndarjen e njesise se tij ne zona; lagje, bllok, fshat dhe cakton personat pergjegjes; administrator të lagjes/kryetar fshati/personi tjetër të ngarkuar që do të kryejnë njoftimin e shtetasve që nuk disponojnë pasaportë.

3. Zyra e gjendjes civile, pasi ka marrë listën emërore me shtetasit që nuk disponojnë pasaportë ndan mbi bazen e adreses listen sipas ndarjeve të kryera sipas pikes 2 dhe ploteson njoftimin për cdo shtetas që nuk disponon pasaportë; (nese ka me shume se nje shtetas që nuk disponon pasaportë për të njejtën familje, emrat e tyre plotesohen në të njejtin njoftim). Plotesimi i njoftimeve behet jo me vonë se data 6.02.2009.

4. Kryetari i bashkisë/njesisë bashkiake/komunës përgatit jo me vonë se data 6.2.2009 për çdo territor të ndarë sipas pikes 2, një dosje me listën emërore të shtetasve dhe njoftimet e plotësuara për shtetasit e kësaj liste.

5. Forma dhe përmbajtja e formularit të njoftimit janë ato të dhëna bashkelidhur këtij udhëzimi. Njoftimi i shtetasit/sve që nuk disponojnë pasaportë, nënshkruhet nga kryetari i bashkisë/njesisë bashkiake/Komunës.

6. Me marrjen e dosjes me njoftimet perkatese, administratori i lagjes/kryetari i fshatit/personi i ngarkuar nisin njoftimin, i cili në çdo rast duhet të jete kryer jo me vonë se 10 shkurt 2009.

7. Administratori i lagjes/kryetari i fshatit/personi i ngarkuar, pasi kanë dorëzuar njoftimin tek shtetasi i kërkojnë atij të nënshkruajnë në listën që ata kanë për të evidentuar lajmërimin. Kryetari informohet rregullisht çdo ditë për ecurinë e procesit të njoftimeve dhe për përfundimin e tij. Kryetari informon rregullisht cdo dite me shkrim prefektin për ecurinë e procesit të njoftimeve. Prefekti informon Ministrinë e Brendshme për përfundimin e procesit të njoftimeve.

8. Çdo 15 ditë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile perditeson listën e personave që nuk disponojnë pasaportë dhe ia dërgon menjehere nepermjet Prefekteve çdo njesie vendore.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefektet, bashkitë/njesisë bashkiake/komunat.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BRENDSHËM**  
**Bujar Nishani**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NJËSIA BASHKIAKE NR. \_\_\_\_\_  
TIRANË

**NJOFTIM**

**DETYRIMIN PËR PAJISJE ME LETËRNJOFTIM ELEKTRONIK**

**I nderuar**

Z, Zj, \_\_\_\_\_ ,  
Emri Atësia Mbiemri

Z, Zj, \_\_\_\_\_ ,  
Emri Atësia Mbiemri

Z, Zj, \_\_\_\_\_ ,  
Emri Atësia Mbiemri

Në zbatim të VKM-së nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, i ndryshuar me VKM-në nr.50, datë 23.1.2009, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka evidentuar faktin që nga verifikimi në bazën e të dhënave të pasaportave, rezulton se ju nuk jeni i pajisur me pasaportë. Në përputhje me dispozitat e VKM-ve të mësipërme, ju jeni i detyruar të aplikoni para datës 30.3.2009 dhe të pajiseni me letërnjoftim elektronik, jo më vonë se data 15 Prill 2009. Aplikimi për letërnjoftimin elektronik kryhet në zyrat e aplikimit pranë zyrës së gjendjes civile të njësisë bashkiake nr. \_\_. Në bazë të VKM-ve të mësipërme, pika 4, për shtetasit që janë në moshën mbi 18 vjeç në datën 28 qershor 2008 dhe nuk disponojnë pasaportë, në rast mospajisjeje me letërnjoftim deri në datën 15 prill 2009 varësisht nga gjendja juaj shoqërore, i punësuar në administratë/pensionist/përfitues i ndihmës ekonomike etj., ju nuk përfitoni:

- pagesa ose shpërblime;
- pagesa apo shpërblime për pensionistët;
- pagesa për ndihmë, përkrahje sociale apo çdo lloj ndihme tjetër të ofruar;
- pranimin në provimet e fundvitit dhe regjistrimin në vitin shkollor/akademik pasardhës për të gjithë ata që ndjekin studimet në shkollat e mesme dhe të larta, pjesëmarrësit në konkurse apo gara të ndryshme të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- pajisja me pasaportë për jashtë shtetit;
- shërbimin në zyrat e gjendjes civile;
- lëshim ose rinovim të lejeve, autorizimeve, licencave nga organet e pushtetit qendror/vendor ndaj personave fizikë dhe përfaqësuesve ligjorë të personave juridikë;
- aplikimi dhe pajisja me certifikatë pronësie nga ana e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- aplikimin për lëshimin e dokumentit “Leje drejtimi automjeti” dhe kolaudimin e tyre;
- lëshimi i vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera të ngjashme me to, nga administrata gjyqësore;
- shërbimet noteriale;
- shpërndarja e karburantit pa akcizë për fermerët;
- shërbimi nga zyrat e Alba-Postës;

Për shërbimet e parashikuara në pikat “e” deri “m”, afatet fillojnë të zbatohen nga 10 shkurt 2009, nëse procesi ka filluar në këtë datë.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj!

**K R Y E T A R I**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMUNA \_\_\_\_\_

**NJOFTIM**

**DETYRIMIN PËR PAJISJE ME LETËRNJOFTIM ELEKTRONIK**

**I nderuar**

Z, Zj, \_\_\_\_\_ ,  
Emri Atësia Mbiemri

Z, Zj, \_\_\_\_\_ ,  
Emri Atësia Mbiemri

Z, Zj, \_\_\_\_\_ ,  
Emri Atësia Mbiemri

Në zbatim të VKM-së nr. 1, datë 7. 01. 2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, i ndryshuar me VKM-në nr.50, datë 23. 01. 2009, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka evidentuar faktin që nga verifikimi në bazën e të dhënave të pasaportave, rezulton se ju nuk jeni i pajisur me pasaportë. Në përputhje me dispozitat e VKM-ve të mësipërme, Ju jeni i detyruar të aplikoni para datës 30. 03. 2009 dhe të pajiseni me letërnjoftim elektronik, jo më vonë se data 15 prill 2009. Aplikimi për letërnjoftimin elektronik kryhet në zyrat e aplikimit pranë zyrës së gjendjes civile të komunës.

Në bazë të VKM-ve të mësipërme, pika 4, për shtetasit që janë në moshën mbi 18 vjeç në datën 28 qershor 2008 dhe nuk disponojnë pasaportë, në rast mospajisjeje me letërnjoftim deri në datën 15 prill 2009 varësisht nga gjendja juaj shoqërore, i punësuar në administratë/pensionist/përfitues i ndihmës ekonomike etj., ju nuk përfitoni:

- a) pagesa ose shpërblime;
- b) pagesa apo shpërblime për pensionistët;
- c) pagesa për ndihmë, përkrahje sociale apo çdo lloj ndihme tjetër të ofruar;
- d) pranimin në provimet e fundvitit dhe regjistrimin në vitin shkollor/akademik pasardhës për të gjithë ata që ndjekin studimet në shkollat e mesme dhe të larta, pjesëmarrësit në konkurse apo gara të ndryshme të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- e) pajisja me pasaportë për jashtë shtetit;
- f) shërbimin në zyrat e gjendjes civile;
- g) lëshim ose rinovim të lejeve, autorizimeve, licencave nga organet e pushtetit qendror/vendor ndaj personave fizikë dhe përfaqësuesve ligjorë të personave juridikë;
- h) aplikimi dhe pajisja me certifikatë pronësie nga ana e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- i) aplikimin për lëshimin e dokumentit “Leje drejtimi automjeti” dhe kolaudimin e tyre;
- j) lëshimi i vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera të ngjashme me to, nga administrata gjyqësore;
- k) shërbimet noteriale;
- l) shpërndarja e karburantit pa akcizë për fermerët;
- m) shërbimi nga zyrat e Alba-Postës;

Për shërbimet e parashikuara në pikat “e” deri “m”, afatet fillojnë të zbatohen nga 10 shkurt 2009, nëse procesi ka filluar në këtë datë.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj!

**K R Y E T A R I**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.2.2009  
Doli nga shtypi më 12.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2009

Çmimi 12 lekë